

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, – kolegji i përbërë nga gjyqtaret: Rasim Rasimi kryetar i kolegjit, Gani Zabeli dhe Shqipe Qerimi anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Hysni Ismaili, në çështjen penale kundër të akuzuarit A.B. nga Glllogoci, për shkak të veprës penale Lëndim i lehtë trupor, parashikuar me nenin 188 par. 1, nën par. 1.4 lidhur me nenin 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), duke vendosur sipas ankesës së mbrojtësit të të akuzuarit av. G.H. të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Dega në Glllogoc, P.nr.70/2015 të datës 07.02.2017, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 12.05.2017, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e mbrojtësit të të akuzuarit A.B. av. G.H., kurse aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Dega në Glllogoc, P.nr.70/2015 i datës 07.02.2017, **Vërtetohet**.

A r s y e t i m

Gjykatës Themelore në Prishtinë – Dega në Glllogoc, me aktgjykimin P.nr.70/2015 të datës 07.02.2017, të akuzuarin A.B., e ka shpallur fajtor për veprën penale Lëndim i lehtë trupor, parashikuar me nenin 188 par. 1, nën par. 1.4 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, dhe e ka gjykuar me dënim me burg në kohëzgjatje prej 3 (tre) muaj, të cilin dënim gjzkata e shkallës së parë ia ka kushtëzuar, ku i njëjti dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari në afat prej 1 (një) viti nuk kryen vepër tjetër penale, e ka detyruar të akuzuarin që në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguaj shumën prej 8.33 € si dhe në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej 50 €, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kanosjen e përmbarimit me dhunë.

Kundër këtij aktgjykimi, në afatin ligjor ankesë ka ushtruar mbrojtësi i të akuzuarit av. G.H. dhe atë vetëm sa i përket vendimit mbi dënimin, me propozim që Gjykata e Apelit në Prishtinë aktgjykimin i ankimuar ta ndryshoj dhe të akuzuarit t'i shqiptohet një vërejtje gjyqësore, ose ta kthejë lëndën rigjykim dhe rivendosje.

Prokurori i Apelit në Prishtinë me parashtresën me shkrim PPA/II.nr. 553/2017, datë 08.05.2017, ka propozuar që ankesa e mbrojtësit të të akuzuarit të refuzohet si e pabazuar, aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit pasi shqyrtoj të gjitha shkresat e kësaj çështje juridiko-penale, studioj aktgjykimin e ankimuar në pajtim me dispozitat e nenit 394 të KPPK-së, dhe pasi vlerësoj pretendimet e cekura në ankesë, gjeti se:

Ankesa është e pabazuar.

Edhe pse aktgjykimi i shkallës së parë nuk ankimohet për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, më gjithat Gjykata e Apelit të njëjtin sipas detyrës zyrtare e shqyrtoj edhe në këtë aspekt, konform dispozitës së nenit 394 të KPPK-së dhe konstatoj se ai nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, e të cilat kishin me kushtëzuar anulimin e tij, si dhe as shkelje të Ligjit Penal në dëm të të akuzuarit.

Po ashtu as gjendja faktike nuk ka qenë objekt vlerësimi e kësaj gjykate, ngase në ankesë nuk ka mundur të kontestohet, sepse i akuzuari në shqyrtimin gjyqësor e ka pranuar fajësinë për të gjitha pikat e akuzës, edhe gjykata është pajtuar me një pohim të tillë, prandaj sipas nenit 383 par. 2 të KPPK-së, ndaj aktgjykimit që është marrë në bazë të pranimit të fajësisë ose marrëveshjes për pranimin e fajësisë nuk lejohet ankesa për gjendjen e fakteve, aktgjykimi i ankimuar u vlerësua vetëm në frymën e pretendimeve ankimore sa i përket vendimit për dënim.

Sa i përket vendimit për dënim, në ankesë e mbrojtësi i të akuzuarit pretendon se gjykata e shkallës së parë me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit nuk e ka bërë vlerësimin drejtë, se nuk ka marrë si rrethanë posaçërisht lehtësuese për të akuzuarin faktin se sulmi fizik filloj së pari nga i akuzuari Jeton Istogu, dhe se pas kësaj i mbrojturi i tij kihste pësuar lëndime dhe i njëjti ishte në gjendje të afektit mendor sepse sulmi kishte ndodhur në një vend publik dhe në prani të personave të tjerë.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, pretendimet e mësipërme ankimore të mbrojtësit të të akuzuarit për një vërejtje gjyqësore, nuk janë të bazuara. Gjykata e shkallës së parë konform dispozitave të nenit 73 të KPRK-së, i ka vlerësuar rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, me ç'rast si rrethana lehtësuese në anën e të akuzuarit ka vlerësuar pranimin e fajësisë në tërësi, më parë nuk ka qenë i gjykuar dhe se ndaj tij nuk zhvillohet procedurë tjetër penale, është penduar për veprën e kryer penale, se ka kërkuar falje dhe moshën e të akuzuarit në kohën

e kryerjes së veprës penale ndërsa rrethana rënduese nuk ka gjetur. Kolegji penal i kësaj gjykate, vlerësimin e këtillë të rrethanave të vlerësuara nga gjykata e shkallës së parë e pranon si të drejtë dhe të bazuar në ligj, prandaj duke pas parasysh të gjitha rrethanat që i ka konstatuar dhe drejtë i ka vlerësuar gjykata e shkallës së parë, faktin se rrethanat e theksuara lehtësuese të pretenduara në ankesën e mbrojtësit të të akuzuarit nuk mund të jenë të asaj rëndësie që do të ndikonin në një dënim më të butë, si dhe duke vlerësuar si rrethanë veçanërisht lehtësuese pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, kjo gjykatë vlerëson se dënimi të cilin të akuzuarit ia ka shqiptuar gjykata e shkallës së parë është në harmoni me shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit si ekzekutor dhe me intensitetin e rrezikimit apo të dëmtimit të vlerës së mbrojtur, posaçërisht duhet të jetë në funksion të preventivës gjenerale dhe individuale, forcimit të moralit të shoqërisë si dhe përgjegjësisë dhe disiplinës së qytetarëve dhe se me dënimin e shqiptuar kryerësi do të parandalohet nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, do të bëhet rehabilitimi i tij dhe do të ndikoj në përmbajtjen e personave tjerë nga kryerja e veprave penale, kjo gjykatë konsideron se me dënimin e shqiptuar të akuzuarit nga ana e gjykatës së shkallës së parë, do të arrihet qëllimi i ndëshkimit i paraparë me dispozitat e neni 41 të KPRK-së.

Nga sa u tha më lartë, konform dispozitës së nenit 401 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS

PA1.nr. 532/2017 datë 12.05.2017

Bashkëpunëtor profesional
Hysni Ismaili

Kryetare e kolegjit
Rasim Rasimi

Anëtarët e kolegjit

Gani Zabeli
Shqipe Qerimi